

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	---	--

<b>Datë/a:</b>	23.05.2019
<b>Për/ Za/ To:</b>	N.N.T." EING COM " Dumosh, Podujevë
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 21.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.N.T." EING COM " lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi I shportave te xhepit dhe uleseve ", me Nr. të Prok: 616-18-5173-121,nxjerr:

## V E N D I M

**Refuzohet** kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.N.T. Eing Com" të dt. 21.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi I shportave te xhepit dhe uleseve ", me Nr. të Prok: 616-18-5173-121,ne Njoftimin e dates 15.05.2019.

1.Autoriteti Kontraktues, per aktivitetin e prokurimit me titull Furnizimi I shportave te xhepit dhe uleseve ", me Nr. të Prok: 616-18-5173-121,ende nuk ka marre Vendim perfundimtar,pasi qe ende nuk eshte pranuar Deklarata e disponueshmerise se mjeteve nga ZKA-ja per te publikuar te njejtin.

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 09.05.2019 ka pranuar nje kerkese nga OE-ik qe te njoftohet lidhur me vazhdimin e procedures per aktivitetin: "Furnizimi I shportave te xhepit dhe uleseve ", me Nr. të Prok: 616-18-5173-121,pasi qe paraprakisht eshte njoftuar per vleresimin e te njejtit.

Me daten 15.05.2019 Autoriteti Kontraktues i eshte pergjegjur dhe e ka njoftuar te njejtin se aktiviteti momentalisht nuk mund te vazhdohet pasi qe Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari pergjegjes per Financa jane deklaruar se nuk rikonfirmojne disponueshmerine e mjeteve per realizim te ketij aktiviteti dhe kjo nenkupton se momentalisht nuk mund te vazhdohet aktiviteti,ndersa Njoftimin perfundimtar do ta merrni pas pranimit te formularit DNPDF-se.Deri ne njoftimin perfundimtar mbetet ne fuqi Vendimi paraprak per anulimin e aktivitetit

Autoriteti Kontraktues sqaron si vijon:

-Duke u bazuar ne Vendimin e personave te autorizuar:Zyrtarit Kryesor Financiar dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe ne nenin 8.7 te Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik ka respektuar Vendimin paraprak per anulim te aktivitetit,pasi qe pa sigurimin e mjeteve financiare nuk mund te nenshkruhet asnje kontrate.Mirepo Vendimi definitiv do te merret pas pranimit te formularit DNPDN-se dhe konstatimit per mos rikonfirmim apo rikonfirmim te disponueshmerise se mejteve.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

#### Këshilla juridike:

Per te parashtruar Kerkese per rishqyrtim duhet te pritni publikimin e Njoftimit perfundimtar,i cili do te publikohet ne E Prokurim dhe nga data e publikimit te te njejtit mund te parashtroni pretendimet tuaja sipas afateve te parapara ligjore .

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

